

VENDIM
Nr. 87, datë 24.2.1997

**PËR MIRATIMIN NË PARIM TË PROJEKTIT TË SHËNDETIT RIPODHUES ME
FONDIN E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR VEPRIMTARITË E POPULLSISË (UNFPA)**

Me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Ambientit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin në parim të projektit të shëndetit riprodhues me Fondin e Kombeve të Bashkuara për veprimtaritë e popullsisë (UNFPA)
2. Ngritjen e njësisë së zbatimit të projektit dhe pagat e punonjësve të saj të jenë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.677, datë 4.9.1995 “Për caktimin e pagave të personelit të njësisë zbatuese të projekteve, kredive apo ndihmave akorduar Qeverisë shqiptare nga institucione ndërkombëtare ose qeveri të vendeve të ndryshme
3. Autorizohet Ministri i Shëndetësisë dhe i Ambientit, ose i autorizuari i tij, të nënshkruajë projektin e shëndetit riprodhues me Fondin e Kombeve të Bashkuara për veprimtaritë e popullsisë (UNFPA).
4. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe e Ambientit të ndjekë zbatimin e projektit të shëndetit riprodhues.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi